PERSON FIZIK BASHKIM MATA



"REHABILITIMI I KANALIT USHQYES TE UJEMBLEDHESIT LLAKAJ"

BASHKIA HAS

P R O J E K T Z B A T I M I

RELACION TEKNIK

SHKURT 2018

RAPORT TEKNIK

OBJEKTI: "REHABILITIMI I KANALIT USHQYES TE UJEMBLEDHESIT LLAKAJ"

BASHKIA HAS

Ujembledhesi Llakaj eshte nje nga veprat ujitese kryesore te Bashkise Has me kapacitet ujembajtes 2 500 000 m^3 dhe aftesi ujitese prej 700 ha.Eshte i ndertuar ne vitin 1965.Ushqehet nepermjet pellgut shimbledhes te Perroit te Vlahnes nepermjet nje vepre marrje.Kjo veper aktualisht eshte jashte funksioni.Nder vite eshte nderhyre per riparimin e saj nga Bordi i Kullimit Kukes por pa arritur rezultatin final.Aktualisht kjo veper eshte e demtuar plotesisht dhe eshte jashte funksionit.Eshte bere nje mbyllje provizore ne menyre qe uji i Perroit te Vlahnes te hyje kanalin e Ushqimit dhe prej aty ne Ujembledhes.
Ujembledhesi i Llakaj sot eshte ne gjendje te mire.Problemi kryesor per kete veper ujitese eshte se mbushja e tij me uje behet vetem me ushqyes nga perroi i Vlahnes.
Kanali egzistues ne gjithe gjatesine e pyllezuar prej 2075 ml ka demtime ne veshjet me beton si dhe mbushje te vazhdueshme me material nga skarpata, gje qe ben te pamundur plotesimin e kapacitetit te furnizimit.
-Ne tokat are me gjatesi rreth 945 ml, zone e pa veshur me beton ka demtuar duke krijuar gerryerje ne dy anet e brigjeve te tokave are.
Per kete arsye eshte e domosdoshme:
Te rindertohet nje veper e re e marrje.
-Kanali ushqyes me gjatesi L=2075 ml qe kalon ne zone pyll, i veshtire per tu pastruar me krah nga mbushjet e pervitshme te shihet mundesia e rindertimit te tij me lugje beton arme.
-Kanali ushqyes me gjatesine 945 ml qe pershkon tokat deri ne rezervuar te vishet me beton.
Per rehabilitimin e ketij segmenti per ta sjelle ate ne parametra te projektit dhe funksionimin normal te tij duhet te parashikohen punime pastrimi, germime me krah e riparime te veprave te artit,kalim me mure betoni,ndertim te veprave te reja te artit,etj.

II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMIT

Detyra e projektimit kërkon të hartohet projekti për: **"Rehabilitimi i Kanalit Ushqyes te Ujembledhesit Llakaj".**
Projekti i zbatimit te hartohet sipas kushteve teknike te projektimit duke marre ne konsiderate te dhenat e mesiperme.
Projekti i zbatimit duhet te paraqese:

- ⇒ Planimetrine, profil gjatesor dhe profila terthore.
- ⇒ Relacionin teknik
- ⇒ Preventivin e punimeve
- ⇒ Specifikimet teknike

Çmimet e vleresimit do ti referohen manualit MTRT. Vlera e ndertim montimit te objektit do te jete deri ne kufirin e 57 000 000 leke me t.v.sh.

III.- RELACIONI TOPOGRAFIK

Nga rikonicioni i kryer ne vend dhe konsultimi me specialistet e Bashkise Has verejme se Vepra e marrjes se ujit per furnizimin me uje te Ujembledhesit Llakaj eshte demtuar plotesisht dhe aktualisht eshte jashte funksioni.Po ashtu kanali Ushqyes i ketij Ujembledhesi nuk i ploteson kushtet teknike per te cilin eshte ndertuar.

Matjet topografike u kryen duke u mbeshtetur ne rrjetin shteteror koordinativ, duke iu pershtatur kerkesave te dhena ne termat e references.

Grupi i topografeve u shoqerua nga inxhinieret hidroteknike dhe inxhinieri gjeolog.

Saktësia e realizuar në matje me GPS-in tonë është +- 1 cm në plan dhe +- 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit.

Në të gjithe zonen e rilevuar u vendosen disa pika të forta me gozhde betoni dhe kunja hekuri të cilat do të shërbejnë gjatë zbatimit të projektit (pikat poligonale).

Pas perfundimit te matjeve ne terren u be perpunimi i matjeve topografike dhe hartimi i dokumentacionit te duhur.

IV.- RELACIONI HIDRAULIK

Duke pare se pellgu shimbledhes i Perroit te Vlahnes ne aksin ku mer uje Ushqyesi i Ujembledhesit Llakaj eshte 3 095 ha ; bejme llogaritjet hidrologjike duke perpunuar reshjet maksimale 24 oreshe per Stacionin Pluviometrik me te afert ate te Krumes.

Perpunimi reshjeve maksimale 24 oreshe Stacioni Pluviometrik Krume

NR	VITI	RESHJE 24 h MAX.	VITI	RESHJET DITORE RENDITUR	P % P=m/n+1*100 %	K= H1d/Hmes 1.354	K-1 +	K-1 -	$(K-1)^2$
1	1973	60.7	1979	90.4	8.33		0.354		0.125316
2	1974	61.2	1977	88.0	16.66	1.318	0.318		0.101124
3	1975	36.0	1987	85.4	25.00	1.279	0.279		0.077841
4	1976	73.0	1986	79.1	33.33	1.185	0.185		0.034225
5	1977	88.0	1976	73.0	41.66	1.094	0.094		0.008836
6	1978	60.0	1974	61.2	50.00	0.917		0.083	0.006889
7	1979	90.4	1973	60.7	58.33	0.909		0.091	0.008281
8	1982	85.4	1978	60.0	66.66	0.899		0.101	0.010201
9	1983	46.0	1987	54.5	75.00	0.816		0.184	0.033856
10	1986	79.1	1983	46.0	83.33	0.689		0.311	0.096721
11	1987	54.5	1975	36.0	91.66	0.539		0.461	0.212521
		734.3		734.3			1.230	1.231	0.715811

$H_{mes} = \sum H_{24h}/n = 734.3/11 = 66.75$

$$C_v = \sqrt{\frac{\sum(k-1)^2}{n-1}} = \sqrt{\frac{0.715811}{10}} = 0.27 \text{ kof. i variacionit}$$

Kofiçienti i asimetrise per reshjet per rastin tone eshte:

$C_s = 4 * C_v = 4 * 0.27 = 1.08$

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS
DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

RELACION

Këshillit Bashkiak Has

PROPOZIM PËR "QYTETARE NDERI" E BASHKISË HAS, ZJ. SANIJE REXHA

Bazuar në ligjin 139/2015"Për vetëqeverisjen vendore", në nenet 22, 41, 43 pika 3, dhe 98 "Kodi i Procedurave Administrative", ligj nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", si dhe të VKM- së Nr.861, datë 10.12.2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", me propozim të Veteranëve të Luftës së UÇK-së me datë 31.01.2026, si dhe në Rregullorën për Organizimin dhe Funksionimin e Administrates së Bashkia Has.

- Dhënien e titullit "Qytetare Nderi"e Bashkisë Has, zj.Sanije Rexha, me motivacionin:
  - **"Për Kontributin e dhënë në çeshtjen kombëtare"**
- **Biografia:**

Zj. Sanije Rexha e lindur në Llaushë, Skenderaj, Kosovë, me datë 27.03.1969. Sanije Rexha është një nga figurat e njohura të rezistencës shqiptare në Kosovë, e vlerësuar për kontributin e saj në luftën për liri, pavarësi dhe në ndërtimin institucional të Kosovës pas luftës. Ajo njihet si bashkëshortja e Abedin Rexhes, me të cilin ndau jo vetëm jetën familjare, por edhe idealin kombëtar për çlirimin e Kosovës.

Sanije Rexha kreu studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Prizrenit dhe më pas Bachelor në Punë Sociale në Fakultetin Helsinki. Që në rini ajo u përfshi në aktivitetet patriotike dhe politike në mbështetje të pavarësisë së Kosovës, sidomos pas demonstratave të vitit 1981. Së bashku me bashkëshortin e saj, ajo mori pjesë në protesta kundër regjimit serb dhe u angazhua në Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës.

Në vitin 1993, Sanije Rexha ndoqi trajnim për Ushtria Çlirimtare e Kosovës në Shqipëri. Për shkak të përndjekjes politike nga regjimi serb, ajo dhe bashkëshorti i saj jetuan për një periudhë në Gjermani, ndërsa në vitin 1997 u kthyen në Kosovë për t'iu bashkuar luftës çlirimtare. Gjatë kësaj periudhe, ajo dha një kontribut të rëndësishëm në mbështetjen morale, organizative dhe logjistike të rezistencës, duke qenë pjesë e grave shqiptare që sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Sanije Rexha u angazhua në administratën komunale të Klinë, duke kontribuar në ngritjen e institucioneve të para të qeverisjes lokale pas luftës. Më pas ajo shërbeu në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, ku punoi në programe sociale për veteranët e luftës dhe familjet e dëshmorëve. Aktualisht është njohur si drejtuese e Skemave të Kategorive të Luftës në këtë institucion.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS
DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Në vitin 2018, Sanije Rexha bëri publik vendimin e saj për kalimin në besimin katolik, duke e cilësuar atë si rikthim në rrënjët familjare dhe kombëtare. Ky deklarim ngjalli diskutime në opinionin publik lidhur me identitetin kombëtar dhe fetar në Kosovë.

Në vitin 2019, ajo u përball me procedura gjyqësore lidhur me pretendime për keqpërdorim të detyrës zyrtare në procesin e verifikimit të veteranëve të luftës, por në vitin 2023 Gjykata Themelore e Prishtinës e shpalli të pafajshme për mungesë provash.

Figura e Sanije Rexhës mbetet simbol i kontributit të grave shqiptare në luftën për çlirimin e Kosovës, i sakrificës familjare dhe i përkushtimit për ndërtimin e institucioneve dhe mbrojtjen e vlerave kombëtare.

Eksperienca profesionale

Administrata Komunale – Klinë, Periudha: Pas vitit 1999

- Kontribut në ngritjen dhe funksionalizimin e institucioneve lokale pas luftës në Kosovë.
- Angazhim në administrimin dhe organizimin e shërbimeve publike komunale.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Prishtinë, Pozita: Zyrtare dhe drejtuese në sektorin social

- Menaxhim i programeve sociale për veteranët e luftës dhe familjet e dëshmorëve.
- Angazhim në administrimin e skemave sociale dhe kategorive të dala nga lufta.
- Koordinim institucional për çështjet e përfitimeve sociale dhe mbështetjes së kategorive të luftës.

Pozita aktuale, Drejtuese e Administrimit të Skemave të Kategorive të Luftës

- Mbikëqyrje dhe administrim i skemave për veteranët, invalidët dhe familjet e dëshmorëve të luftës së Kosovës.
- Bashkëpunim me institucionet shtetërore për zbatimin e legjislacionit social dhe të kategorive të luftës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, pas verifikimit të të gjitha elementëve të kërkuar nga ligji Nr.112/1013, "Përdekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë"(*i ndryshuar*),të aktit të propozimit,vlerësojmë përshtatshmërinë e dhënies së titullit "Qytetare Nderi"e Bashkisë Has zj.Sanije Rexha.

Drejtor i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Imer Dauti

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati I Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Bashkia Has
Tel/Fax: +355 214 22080, E- mail: info@bashkiahas.gov.al.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS

RELACION

Këshillit Bashkiak Has

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të funksioneve dhe përgjegjësive të Bashkisë Has në garantimin e transparencës në veprimtarinë e saj, një nga detyrimet që bashkia ka, është dhe miratimi i programit tëtransparencës, parashikuar nga neni 15 i ligjit nr 139/2015 "Për vetëqevcrisjen vendore", i ndryshuar. Në zbatim të kësaj dispozite bashkia Has do të miratojë programin e transparencës me afat rishikimi 4 (katër) vjet.

Në vijim rezulton që organi kompetent Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar, nëpërmjet Urdhërit nr.281, datë 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", ka vendosur : Miratimin e Programit Modeltë Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet kërij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri te gjitha njesitë e vetëqeverisjes vendore, bashki dhe këshilla qarqesh.

3. Autoritetet publike të përcaktuara në pikën 2 të kërij urdhri, zbatojnë Programin institucional të Transparencës, sipas formës dhe përmbajijes, në përputhje me lidhjen nr. 1.bashkëlidhur këtij urdhri, jo më vonë se data 31 Mars e vitit pasardhës .

4. Urdhri nr. 211, datë 10.9,2018, "Për miratimin e programit të transparencës të njësive tëvetëqeverisjes vendore",shfuqizohet, vijohet me miratimin e programit të transparencës sipas materialit bashkëngitur urdherit nr.281, datë 30.12.2025.

Mbështetur në modelin e programit të transparencës miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informitit dhe Mbrojtjen e të Dhenave Personale, me urdherin nr.281, datë 30.12.2025

PROPOZOJMË:

- Miratimin i programit të Transparencës për Bashkinë Has,sipas lidhjes bashkangjitur.
- Ky program mbështetet në parimet e mëposhtme:
- Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të vetëqeverisjes vendore.

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati I Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Bashkia Has

Tel/Fax: +355 214 22080, E- mail: info@bashkiahas.gov.al.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS

Transparenca është publikimi i informacionit mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, menaxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofron bashkia, pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje, legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e te dhenave personale dhe privatësinë.

Transparenca dhe llogaridhënia janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me komunitetin.

Detyrimet ligjore që njedhin nga ligji Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", dhe ligjinr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" u garantojnë qytetarëve akses në qeverisjedhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare. Nëpërjet Programit të Transparencës, Bashkia Has vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet të tyre si dhe proçedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Për garantimin e të drejtës së informimit, bashkia në hartimin e Programit të Transparences është bazuar në parimin e :

a) Vendosjes në dispozicion të çdo qytetari, të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e bashkisë (nga organet e saj, administrata,njësitë administrative dhe njësitë e varësisë).

b) Ligjshmërisë, transparencës dhe të mos diskriminimit.

c) Ofrimit te informacionit pa pagesë. Informacioni i kërkuar në rugë elektronike ijepet,çdo qytetari pa pagesë. Çdo qytetar përfiton informacion pa pagesë deri në 10 faqe, mbi këtë numër faqesh qytetari puguan një tarife shërbimi sipas tarifave të miratuar ngakëshilli bashkiak.

d) Aksesit për këdo. Aksesi për shtresat më të varfra të komunitetit ,qytetarët me aftësi tëkufizuar, gratë, të rinjtë, biznesin, fermurët, qytetarët e zonave të largëta etj., merrpërparësi.

e) Thjeshtëzimin të procedurave administrative për aksesin në informacion.

f) Dhënies së informacionit sa më shpejt që të jetë e mundur.

g) Cilesisë se informacioni.cdo informacion në dispozicion të qytetarëve do të jetë:-i plotë;- i saktë; - i përditësuar; - i thjeshtë në konsultim;- i kuptueshëm;- lehtësisht i aksesueshëm;- i pajtueshëm me dokumentat origjinale në administrim të bashkisë; - lehtësisht i përdorshëm.

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm kategoritë einformacionit, të parashikua shprehimisht në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"(në vijim ligji), janë përshlatur me kontekstin e vetëqeverisjes vendore; me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë. Në këtë optikë tabela përmbledhëse e Programit është ndarë në 8 fusha kryesore:

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS

Fusha e parë: Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, përfshin kategoritë e informacionitqë bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika:a; d; g; ç, dh) i ligjit . Kjo fushë iu ofron qyetatrëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre , për misionin dhe funksionet e bashkisë, për administratën e bashkisë, për statistikat vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimete organeve dhe administratës së bashkisë.

Fusha e dytë: Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare, përfshin kategoritë einformacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika: dh; c; ë) i ligjit. Këto kategori informacioni janëpërshtatur me kërkesat e ligjit Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" i ndryshuar.

Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin ,monitorimin, mbikqyrjen dhe auditimin e buxhetit , me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe aseteve.

Fusha e tretë: Për kërkesat për informin,përfshin vendosjen në dispazicion të qytetarëve tëinformacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k)tëligjit ,në një fushë të vetme , lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim.

Fusha e katërt: Mbi shërbimet që ofron bashkia ,përfshin informacion mbi shërbimet që ofronbashkia të përcaktuara në nenin 7 (pika: f. j; ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit.

Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni mbi shërbimet publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurën e ankimit në lidhjë me kontratat publike,standartet, treguesit,proceduratpër të përfituar shërbime si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Fusha e pestë: Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore, informacion i përcaktuar në nenin 7,pika b të ligjit .Kjo fushë u ofron qytetareve informacion për legjislacionin, politikat, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat karakter normativ të organeve të bashkisë. Për të lehtësuar qasjen në informacion, fusha e legjislacionit është ndarë sipas funksioneve.

Fusha e gjashtë: Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimarrje,përfshin informacion në lidhje meprocesin,procedurat,kuadrin rregullator vendor,listen e akteve vendore që i nënshtrohenkonsultimit publik dhe nismat qytetare.

Fusha e shtatë: Informacion tjetër, bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshme të tillë si proceset e integrimit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte ,studime

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Bashkia Has
Tel/Fax: +355 214 22080, e - mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS

dhe vlerësime të ndryshme,veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj ; vetorganizimi komunitar etj.

Fusha e tetë: Këshilli Bashkiak, përfshin veprimtarinë e këtij organi të rëndësishëm. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion rreth këshilltarëve, komisioneve, kuadrin rregullator të Këshillit Bashkiak Has, konsultimet publike, kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit Bashkiak Has, veprimtarinë e Këshillit, komunikim me publikun dhe aspekte të tjera.

Përfundimisht, mbështetur në nenet 15, 18 pika 3 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; nenet 5, 6 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar; ligjin nr.9887,datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar; Urdhërin nr.281, datës 30.12.2025 "Për miratimin e programit model të transparences për njësitë e vetëqeverisjes vendore" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale"

Ju ftojmë për miratimin e Projekt-Vendimit për Programin e Transparences në Bashkinë Has.

Emirela Kurpali
Specialiste Komunikimi

Erisa Ferizolli
Përgjegjëse e Sektorit Juridik

KRYETAR
Miflar DALLTI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjetër Bogdani", Qyteti Krumë, Bashkia Has
Tel/Fax: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Nr.1764/Prot.

Date 15/05/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.6 Date 15.05.2026,"Tavanet e pergjithshme pergatitore të PBA 2027-2029.

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026",

I. Qëllimi i projekt vendimit

Ky projektvendim paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak Has në kuadër të procesit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2027–2029, Faza I, me qëllim miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për periudhën trevjeçare 2027–2029.

Përcaktimi i tavaneve buxhetore synon garantimin e një planifikimi financiar të qëndrueshëm, harmonizimin e prioriteteve strategjike të zhvillimit vendor me burimet financiare të disponueshme dhe rritjen e eficiencës në përdorimin e fondeve publike.

II. Përmbajtja e projektvendimit

Programi Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 përfaqëson instrumentin kryesor të planifikimit financiar të Bashkisë Has, duke përcaktuar objektivat strategjikë, programet buxhetore dhe burimet financiare për një periudhë trevjeçare.

Tavanet përfundimtare janë hartuar mbi bazën e:

- parashikimeve të të ardhurave vendore;
- transfertave nga buxheti i shtetit;
- prioriteteve të zhvillimit vendor;
- nevojave për financimin e shërbimeve publike;
- projekteve investuese dhe objektivave afatmesëm të bashkisë.

Duke qenë se tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 janë përgatitur në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, propozohet miratimi i tyre nga Këshilli Bashkiak Has.

Miratimi i këtij projektvendimi do të mundësojë vijimin normal të procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm dhe hartimin e dokumenteve buxhetore për vitet në vijim.

Konceptoi:

Grislanda Bajraktari
Përgjegjëse Finance

Konfirmoi:

Sahit Meshi
Drejtor Finance

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

KRYETAR
Milla DAUTI

Adresa: Sheshi "Deshmorët e Hasit", Pallati i Kulturës "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has.
Tel/Fax.: +355 214 22080, Email:info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Nr.1766 Prot. Date 15/05/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.8 Date 15.05.2026,"Raportimi i monitorimit buxhetit për4 mujorin e pare 2026.

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", paraqitet për miratim raporti i monitorimit Janar-Prill 2026.

Raporti pasqyron ecurinë e realizimit të të ardhurave, shpenzimeve dhe investimeve sipas programeve buxhetore të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

- ANALIZA E TË ARDHURAVE

Gjatë periudhës Janar–Prill 2026 burimet kryesore të të ardhurave kanë qenë; të ardhurat nga taksat vendore; të ardhurat nga tarifat vendore; transfertat e pakushtëzuara nga buxheti i shtetit; transfertat specifike dhe të kushtëzuara.
Analiza tregon se ritmi i arkëtimit të të ardhurave është në përputhje ndaj planifikimit vjetor kundrejt shpenzimit, duke krijuar kushtet për financimin normal të funksioneve dhe shërbimeve vendore.

- ANALIZA E SHPENZIMEVE

Shpenzimet totale të realizuara për periudhën raportuese janë në masën 214,595,033 lekë ose 31% e planit.
Shpenzimet sipas natyrës ekonomike paraqiten si vijon; shpenzime personeli; sigurime shoqërore; shpenzime operative; investime kapitale dhe transferta dhe subvencione.
Realizimi i shpenzimeve është kryer në përputhje me fondet e miratuara dhe nevojat e programeve buxhetore.

- ANALIZA SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE

Programet kryesore të Bashkisë Has kanë vijuar realizimin e objektivave të tyre sipas treguesve të miratuar ne fillim te vitit buxhetor me VKB Nr.109 date 24.12.2025:
Veçanërisht evidentohet: administrimi i përgjithshëm vendor; shërbimet publike vendore; arsimi parashkollor; mbrojtja sociale; infrastrukturat dhe investimet publike.
Niveli i realizimit të secilit program paraqitet në tabelat shoqëruese të monitorimit.

- INVESTIMET

Gjatë 4-mujorit të parë janë financuar dhe ndjekur projektet e investimeve të planifikuara në buxhet dhe projektve ne vazhdim nga viti 2025.
Realizimi i investimeve paraqitet në nivelin 8% të planit , ndërsa projektet e tjera janë në proces vijojnë sipas grafikut të zbatimit dhe procedurave.

Analiza e treguesve financiarë tregon se buxheti i Bashkisë Has për periudhën Janar–Prill 2026 është zbatuar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, eficiencës dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike.
Faleminderit per bashkepunimin.

Konceptoi:

Grislanda Bajraktari
Përgjegjëse Finance

Konfirmoi:

Sahit Meshi
Drejtor Finance

KRYETAR

Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE DHE I PËRKUJDESJES SOCIALE

Krumë me 15.05.2026

Relacion

Për
Përdorimin e fondit të kushtëzuar për Bllok-Ndihmën deri në 6% për muajin Prill 2026

Në mbështetje të ligjit nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.9.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Përkujdesjes Sociale ka shqyrtuar dhe përpunuar aplikimet për përfitim nga fondi shtesë deri në masën 6% për muajin **Prill 2026**, dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ka kryer përzgjedhjen sipas prioriteteve dhe dokumentacionit të paraqitur në dosje.

Fondet në dispozicion për muajin Prill 2026, sipas Vendimit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, gjithsej **189 familje**, me një fond total prej **900.796 lekë janë si më poshtë:**

- **Krumë:** 61 familje, me fond mujor **287.379 lekë.**
- **Njësia Administrative Golaj:** 61 familje, me fond mujor **322.259 lekë**
- **Njësia Administrative Fajza:** 48 familje, me fond mujor **202.791 lekë**
- **Njësia Administrative Gjinaj:** 19 familje, me fond mujor **88.367 lekë**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, janë marrë vendimet si më poshtë:

1.Njesia Administrative Fajza : Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike

- Skender Dervish Mazrreku

Shtohet ne fondin 6%:-

2. Njesia Administrative Golaj Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike

- Ardit Dauti

Shtohet ne fondin 6%:

- **Kade Mulaj**
- **Shahe Xhafa**

3.Njesia Administrative Gjinaj : Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike-

Shtohet ne fondin 6%:

- Mehdi Bajram Thaçi

4.Njesia Qender Krume: Refuzohet për trajtim me ndihmë ekonomike

- **Ramiz Aliaj**
- **Tahir Maçi**

Shtohet ne fondin 6%:

P/Sek/Nd/Ekonomike

Dritan ÇERKEZI

Dritan cerkezi

Digitally signed by Dritan cerkezi
Date: 2026.05.15 14:02:01 +02'00'

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCAT CIVILE

Nr.513/1 Prot.

Krumë, me 28 / 07 /2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK HAS

PËR

Miratimin e kërkesës së Bashkisë Has së bashku me dokumentacionin tekniko-ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e Z. Qemal Din Ukperaj banesa e të cilit është dëmtuar nga fatkeqësi natyrore.

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54, ligjit Nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" Neni 30 shkronja "gj", VKM Nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore", kërkojmë:

Miratimin e dëmit të shkaktuar në banesën e tij në ***Fshatin Perollaj, Lagjia Ukperaj, Njësia Administrative Golaj,*** **Bashkia Has**, ***nga Fondi i Kushtëzuar i Buxhetit të Shtetit për vitin 2026.***

Bazuar në kërkesën e shtetasit, drejtuar Bashkisë Has (Drejtorise Mbrojtjes Civile) për të ndihmuar këtë shtetas pasi banesa e tij është dëmtuar nga reshjet e shiut. Nga ana e jonë në bazë të urdhërit të ngritur për të bërë verifikimin e këtij rasti, u bë verifikimi në vend dhe rezultoj si me poshtë:

- Çarje në muret e shtëpise.
- Çarje sovatimesh ne muret e brendshme të shtëpisë.
- Verifikimi u shoqërua me fotografi.

	Emri, Atësia, Mbiemri	Lloji i Fatkeqësisë	PREVENTIVI	Masa e Kompensimit
1	Qemal Din Ukperaj	Fatkeqësi Natyrore		
	PREVENTIV NDËRTIMI		424,844 Lekë	50% 212,422 Lekë
	TOTALI			**212,422 Lekë**

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

Në mbështetje të VKM Nr.329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore".

Vlera totale e preventivit të banesës për të cilën ka për të marrë qytetari z. Qemal Din Ukperaj është **212,422 Lekë**.

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

Fatos Ahmati

Sektori Juridik

Erisa FERIZOLLI

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

Arbërie Rada

KRYETARI

Miftar DAUTI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCAT CIVILE

Nr.1767 Prot. Krumë, me 15 / 05 /2026

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK HAS

PËR

